



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 12.11.2019)

Pika 1 shtesë e rendit të ditës me objekt: Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave: 24.10.2019 dhe 29.10.2019.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:40 dhe mbaroi në orën 15:22.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Maksim Qoku | (zëvendëskryetar) |
| 3. Medi Bici | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 6. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 7. Ilir Toska | (anëtar) |
| 8. Alban Toro | (anëtar) |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtar) |
| 10. Marçela Shehu | (anëtare) |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, **zoti Erjon Muharremaj**.

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. **Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
2. **Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
3. **Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
4. **Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.**
5. **Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.**
6. **Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.**
7. **Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
8. **Klodian Rado, EURALIUS.**
9. **Gregor Borkowski, EURALIUS.**
10. **Përfaqësues i EURALIUS.**

RENDI I DITËS:

1. (Pikë shtesë) - Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave: 24.10.2019 dhe 29.10.2019.

Naureda Llagami: Fillojmë mbledhjen e programuar më datën 12 nëntor 2019. Nga anëtarët janë të gjithë të pranishëm, përveç zotit Muharremaj i cili është në një aktivitet jashtë vendit, duke përfaqësuar Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Siç jeni në dijeni, lidhur me rendin e ditës, sot në rend të ditës janë 4 çështje kryesore, por unë do doja të propozoja një shtesë në rendin e ditës që lidhet me miratimin e procesverbaleve për mbledhjet e datës 24 dhe 29 tetor. Nëse jeni dakord me shtesën e propozuar nga unë për procesverbalet, ju lutem votojmë?

Maksim Qoku: Dakord.

(Vota e zonjës Kadi nuk dëgjohet.)

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Dakord, e fillojmë me miratimin e procesverbaleve për mbledhjet e datës 24 tetor dhe 29 tetor?

Maksim Qoku: Dakord.

(Vota e zonjës Kadi nuk dëgjohet.)

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Votoj vetëm për procesverbalin e datës 29 sepse me datë 24 nuk kam qenë.

Naureda Llagami: Dakord.

* * *

(Pika 1 shtesë e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 12.11.2019)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton këtë pikë të rendit të ditës Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Maksim Qoku.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:40 dhe mbaroi në orën 15:22.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Maksim Qoku | (zëvendëskryetar) |
| 2. Medi Bici | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 5. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 6. Ilir Toska | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Brikena Ukperaj | (anëtar) |
| 9. Marçela Shehu | (anëtare) |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, **zoti Erjon Muharremaj**. Gjithashtu, nuk mori pjesë në këtë pikë të rendit të ditës Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **zonja Naureda Llagami**.

1. **Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
2. **Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.**
3. **Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.**
4. **Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.**

RENDI I DITËS:

5. Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

(Rifillon mbledhja plenare në drejtimin e Zëvendëskryetarit, z. Maksim Qoku.)

Maksim Qoku: Atëherë, fillojmë mbledhjen.

Në pamundësi të qenies së Kryetares për efekt të angazhimeve në Këshill, mbledhjen e drejtoj unë.

Vazhdojmë me pikën e fundit në lidhje me caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme. Relatori përkatës, kush do të merret me...?

Ju lutem, administrata ndihmoni pastaj me procedimin. Faleminderit!

Ilir Toska: Faleminderit!

Atëherë, sot kemi kërkesa nga 20 gjykata të cilat janë në nevojë për caktim gjyqtari në çështje gjyqësore të veçanta. Në ditën e sotme, me bashkëpunimin e Misionit EURALIUS është bërë e mundur të ndërtohet një softuer (*software*) për ta zhvilluar shortin në mënyrë elektronike. Gjithsesi, shorti konsideron të gjitha kriteret që ne kemi caktuar në vendimin e Këshillit për caktim gjyqtari për çështje gjyqësore të veçantë në

një gjykatë tjetër të ndryshme nga ajo që ushtron funksionet, konsideron shpërndarjen e barabartë të çështjeve dhe kriterin e ekonomizimit të burimeve njerëzore. Gjithsesi, por si procedura e mëhershme, ne do të japim propozimet tona për mënyrën e shpërndarjes së çështjeve. Këshilli paraprakisht do duhet të votojë dhe pastaj nëpërmjet sistemit elektronik, do të gjenerojë përzgjedhjen e gjyqtarëve për çështje të veçanta.

Fillimisht, propozimi është për radhën e procedurave të shortit që duhet të ndiqen. Propozimi konsiston në këtë përmbajtje. Fillimisht gjykatat e shkallës së parë sipas kësaj radhe: Gjykatat e shkallës së parë sipas juridiksionit të gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm, dhe konkretisht gjykata e shkallës së parë në juridiksionin e Gjykatës së Apelit Tiranë: fillimisht Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, më pas Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin dhe në fund, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat.

Më pas, procedurat e shortit vijnë me gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Durrës: fillimisht Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, më pas Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe në fund Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë.

Më pas procedurat e shortit të vijnë me gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë: fillimisht Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë dhe më pas Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet.

Më pas procedurat e shortit të vijnë me gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Korçë: fillimisht Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec, që është gjykatë e vetme në nevojë në këtë juridiksion.

Më pas procedurat e shortit të vijnë me gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Vlorë: fillimisht Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat dhe më pas Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Në përfundim procedurat e shortit të vijnë me gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Shkodër: që është vetëm Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë.

Më pas, për gjykatat e shkallës së parë, procedurat e shortit të vijnë me juridiksionin administrativ sipas kësaj radhe: fillimisht Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë dhe më pas Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.

Më pas procedurat e shortit të vijnë me gjykatat e apeleve sipas kësaj radhe: gjykata e apelit me juridiksion të përgjithshëm: fillimisht Gjykata e Apelit Korçë, më pas Gjykata e Apelit Vlorë, më tej Gjykata e Apelit Gjirokastër dhe në fund Gjykata e Apelit Shkodër.

Më pas procedurat të vijnë me Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda dhe në përfundim procedurat e shortit të vijnë me ato të Gjykatës së Lartë.

Jeni dakord me këtë propozim?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Atëherë do vazhdojmë me procedurat e shortit për secilën nga gjykatat.

Ndërkohë unë do ju lexoj propozimet. Propozimet paraprakisht janë hedhur nga punonjësja e Këshillit në sistemin elektronik. Nëse Këshilli miraton propozimet, atëherë mund të vijojmë menjëherë me shortimin elektronik të çështjeve.

Fillojmë me **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë**. Për këtë gjykatë dhe për të gjithë 19 gjykatat e tjera, bëhet e nevojshme aplikimi i vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për caktim gjyqtari në çështje gjyqësore të veçanta në gjykatë tjetër të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, për shkak të pazbatueshmërisë së mekanizmit të skemës së delegimit, për shkak të padisponueshmërisë, të mungesës së gjyqtarëve në skemë delegimi si dhe për shkak të padobishmërisë së zbatimit të mekanizmit të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, ndërsa nevojat e identifikuar të gjykatave janë të atilla ku nuk është e dobishme transferimi i përkohshëm i gjyqtarëve për një numër të kufizuar të çështjeve.

Po vijojmë me propozimet konkrete për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë. Kjo gjykatë ka paraqitur nevojë në 5 çështje, të cilat janë në lëndë penale. Propozimi është që gjykata nga duhet të përzgjidhen me short gjyqtarët që do caktohen për gjykimin – janë 6 çështje në fakt, 6 çështje në total, 5 çështje penale, 1 civile – propozimi është që gjykata nga duhet të përzgjidhen me short gjyqtarët që do caktohen për gjykimin e 6 çështjeve gjyqësore të veçanta të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 6 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 3.

Në opsionin e pranimit të propozimit si më lart, propozimet vijuese janë që për çështjet penale: Për çështjet nr.3 dhe nr.5, për të cilat kërkohen 2 gjyqtarë, ata të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Seksionit Penal të Çështjeve Penale të Themelit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Për çështjet nr.1, nr.2 dhe nr.4, për të cilat kërkohet 1 gjyqtar, për secilën nga ato, ai të përzgjidhet me short nga gjyqtarët e caktuar për çështjet nr.3 dhe nr.5, ku në këtë rast, gjyqtari i përzgjedhur për çështjen e përzgjedhur më parë, përjashtohet nga shorti për çështjen tjetër.

Sa i përket çështjeve civile, që është vetëm 1, që është çështja nr.6, për të cilën kërkohet 1 gjyqtar, në respektim të vendimit nr. 238/1/a, datë 24.12.2008 “Për procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore”, të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i cili është i zbatueshëm për sa nuk vjen në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, si i përzgjedhur nga shorti të konsiderohet gjyqtari {...}, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, i cili është caktuar më herët për gjykimin e kësaj çështjeje, ndërsa në atë rast ka vendosur pushimin e gjyimit të saj.

Propozimet vijuese janë për sa i përket përjashtimit nga procedurat e shortit, janë këto propozime: në shortimin e çështjeve penale të përjashtohen nga shorti gjyqtarja e Seksionit Penal të Çështjeve Penale të Themelit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë që është me leje lindjeje, konkretisht znj. {...}.

Propozimi tjetër është që në shortimin e çështjeve penale të përjashtohet nga shorti Kryetari në detyrë (Zëvendëskryetari) i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, z. {...}.

Po kështu, në shortimin e çështjeve penale të përjashtohet nga shorti gjyqtari i Seksionit Penal të Çështjeve Penale të Themelit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë i cili ka pengesë ligjore për gjykimin e disa prej tyre, konkretisht z. {...}.

Jeni dakord me propozimet si më lart?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Dakord.

Mirë atëherë. Të gjithë propozimet janë hedhur në sistem dhe do të vijojmë me procedurën e shortimit elektronik për çështjet.

Po! Mund të flisni edhe për rezultatet e shortit.

Brunilda Kadi: Të bëj një pyetje, meqë është në testim ky. Për shembull, nëse në këtë propozimin që bëtë ju do kishte një vendimmarrje të ndryshme nga Këshilli, është në moment e editueshme nga sistemi për t'u ndryshuar?

Ilir Toska: Po, patjetër! Ne mund të ndryshojmë propozimet dhe të bëjmë një propozim tjetër.

Brunilda Kadi: Jo! E kam fjalën, për të ekonomizuar kohën. Nuk merr shumë kohë për shembull, në qoftë se do ketë një vendimmarrje të ndryshme?

Ilir Toska: Do duhet të fillojmë të bëjmë procedurën për ta rikonsideruar propozimin me një propozim tjetër.

Brunilda Kadi: Merr kohë kjo për ta bërë në sistem?

Ilir Toska: Jo, nuk merr shumë kohë!

Valbona Bako: Atëherë, për çështjen 3 dhe 5, që kërkohen 2 gjyqtarë, gjyqtarët e përzgjedhur nga sistemi janë gjyqtarët {...} dhe {...}.

Ndërkohë për çështjen 1, 3 dhe 4, që është bërë shorti midis këtyre gjyqtarëve, për çështjen e parë, gjyqtarja e përzgjedhur është {...} dhe për çështjen e dytë është gjyqtari {...}, dhe për çështjen e tretë është gjyqtarja {...}.

Ilir Toska: Këtu u mbyll procedura për 5 çështjet penale.

Sistemi e gjeneron të gjithë raportin.

Ndërkohë që për çështjen civile është gjyqtari {...} (çështja nr.6).

Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë.

Vazhdojmë procedurat e shortit për **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin**. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin ka paraqitur nevojë për 1 çështje, që është në lëndë penale dhe kërkohet caktimi i 2 gjyqtarëve. Propozimi i Komisionit është që gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 2.

Në rast të pranimit të opsionit si më lart, kemi propozimet vijuese sa i përket përjashtimeve nga shorti, që konsiston vetëm në një propozim, të përjashtohet nga shorti kryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, zoti {...}.

Jeni dakord?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Mirë atëherë, mund të vazhdosh me procedurën e shortit.

Valbona Bako: Atëherë, gjyqtarët e përzgjedhur janë {...} dhe {...}.

Ilir Toska: Me kaq, mbyllet procedura e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat**. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat ka paraqitur nevojë në 2 çështje, që janë në lëndë penale. Në secilën nga ato kërkohen nga 1 gjyqtar. Propozimi i Komisionit është që gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 1.

Në këtë rast, sa i përket përjashtimeve nga shorti, Komisioni propozon që të mos përjashtohet nga shorti kryetarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, zonja {...} për shkak të numrit të kufizuar të gjyqtarëve të kësaj gjykate dhe numrit jo të lartë të çështjeve.

Jeni dakord?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Atëherë, vijojmë me procedurat e shortit.

Valbona Bako: Gjyqtarja e përzgjedhur është gjyqtarja {...}, për të dyja çështjet.

Ilir Toska: Me kaq mbyllet procedurat e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat.

Vazhdojmë me gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të apelit Durrës që është **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës**. Ka paraqitur nevojë në 1 çështje që është në lëndë civile. Kërkohet caktimi i 1 gjyqtari.

Propozimi i Komisionit është që gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1.

Në këtë rast propozimet vijuese janë sa i përket përjashtimeve nga shorti. Është propozuar të përjashtohet nga shorti gjyqtarja që ka pengesë ligjore e Seksionit Civil të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që është zonja {...}.

Po kështu të përjashtohet nga shorti, për shkak të vendimit të mëhershëm të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për përjashtim nga procedurat e shortit të gjyqtarit të Seksionit Civil të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, zotit {...}.

Po kështu, propozimi vijues për përjashtim nga shorti është edhe sa i përket gjyqtarëve së Seksionit Civil të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të cilët janë caktuar më herët në gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, që janë: {...} ... {...}.

Jeni dakord?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Atëherë, vijojmë me procedurat e shortit.

Valbona Bako: {...}.

Ilir Toska: Mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës. Vijojmë me **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan**. Ka paraqitur nevojë për një çështje civile. Kërkohet caktimi i 1 gjyqtari. Propozimi i Komisionit është që gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1, që duhet të zgjidhet nga Seksioni Civil i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, sipas lëndës së çështjes.

Sa i përket propozimeve për përjashtimin nga shorti. Si më herët, të përjashtohet nga shorti zoti {...}, gjyqtar i Seksionit Civil i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që është përjashtuar nga lista e gjyqtarëve që mund të caktohen për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Po kështu, të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e seksionit civil të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të cilët janë caktuar më herët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme, që janë: {...} ... {...}.

Po kështu, të përjashtohen nga shorti edhe gjyqtari i Seksionit Civil i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë që do të caktohet për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, që më herët u zgjodh zonja {...}, e cila duhet të reflektohet.

Mirë atëherë, vazhdojmë me procedurat e shortit.

Valbona Bako: Gjyqtarja {...}.

Ilir Toska: Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan. Vazhdojmë me **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë**. Ka paraqitur nevojë në 1 çështje në lëndë penale, për të cilën kërkohet caktimi i 3 gjyqtarëve.

Propozimi i Komisionit është që gjykata nga duhet të përzgjidhen gjyqtarët që do caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe numri i gjyqtarëve që do caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 3, të cilët do të përzgjidhen nga gjyqtarët e Seksionit Penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Në këtë rast, gjyqtari i përzgjedhur i pari është dhe relator i çështjes.

Këto ishin propozimet.

Jeni dakord?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Dakord. Vazhdojmë atëherë me procedurën e shortit.

Valbona Bako: Janë gjyqtarët: {...}, {...} dhe {...}. Në fakt sistemi e zgjedh vet relatorin, është {...}. Gjyqtarja {...}.

Ilir Toska: Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë.

Vazhdojmë me procedurat e shortit për gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë. Fillimisht, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, e cila ka paraqitur nevojë në 3 çështje (2 në lëndë civile dhe 1 në lëndë penale). Kërkohet caktimi i 1 dhe 2 gjyqtarëve.

Propozimi i Komisionit është që gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 3 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jenë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet dhe Gjykata e Rrethit

Gjyqësor Vlorë. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 3 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 3 ose 4, në varësi të rezultateve të shortit.

Më konkretisht, sa i përket hapave të shortit është: Për çështjen civile nr.1, për të cilën kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, ai të përzgjidhet me short, nga gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet.

Për çështjen civile nr.2, për të cilën kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, ai të përzgjidhet me short, nga gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, i ndryshëm nga ai që do të caktohet për çështjen nr.1. Referuar palëve dhe objektit që kanë këto dy çështje duket sikur kanë një interferencë mes tyre, prandaj është bërë ky propozim.

Ndërsa për çështjen penale nr.3, për të cilën kërkohen 2 gjyqtarë, ata të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Seksionit Penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Lidhur me propozimet e tjera vijuese, janë ato që kanë të bëjnë me përjashtimet nga shorti. Është propozuar të përjashtohet nga shorti gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, zonja {...} e cila ka paraqitur kërkesë dhe është në procedurë trajtimi për përjashtim nga procedurat e shortit për caktim gjyqtari në një çështje gjyqësore të veçantë në gjykata të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, kërkesë kjo e përsëritur. Ndërsa më herët Këshilli ka vendosur ta pranojë atë kërkesë.

Po kështu të përjashtohen nga shortimi i çështjes civile nr.2, gjyqtari që do caktohet për çështjen nr.1.

Në shortimin e çështjes penale, të përjashtohet nga shorti kryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, zoti {...}.

Nga ana tjetër, kemi propozuar të mos përjashtohen nga shorti për 2 çështjet civile kryetarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, zoti {...} dhe zoti {...}, për shkak të ngarkesës relativisht jo të lartë dhe numrit të kufizuar të gjyqtarëve në ato gjykata.

Jeni dakord me propozimet?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Dakord. Vijojmë me procedurat e shortit atëherë.

Valbona Bako: Fillimisht është shorti për çështjen 1 dhe 2, që i marrim nga Përmeti dhe Saranda. Për çështjen e parë gjyqtarja e përzgjedhur është {...}. Për çështjen e dytë gjyqtarja e përzgjedhur {...}.

Gjyqtarët e përzgjedhur janë gjyqtarët {...} dhe {...}. (*çështja penale*).

Ilir Toska: Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet**. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet ka paraqitur nevojë për 1 çështje, që është në lëndë penale. Kërkohet caktimi i 1 gjyqtari.

Propozimet e Komisionit janë që gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1.

Në këtë rast, propozimet vijuese janë sa i përket përjashtimeve nga shorti. Propozohet që të përjashtohet nga shorti vetëm kryetari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, zoti {...}.

Jeni dakord me propozimet?

(*Anëtarët e Këshillit janë dakord.*)

Vazhdojmë atëherë me procedurat e shortit.

Valbona Bako: Pëllumb Vehbi.

Ilir Toska: Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet.

Vijojmë me gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Korçë, që është vetëm **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec**, që ka paraqitur nevojë në 2 çështje, që janë të dyja në lëndë penale dhe kërkohet caktimi i 1 gjyqtari. Propozimi i Komisionit është që gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 1.

Në propozimet vijuese, janë sa i përket përjashtimeve nga shorti, që konsistojnë në përjashtimin nga shorti të kryetares në detyrë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, zonja {...}. Po kështu të përjashtohen nga shorti edhe gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë që janë caktuar më herët në gjykimin e dy apo më shumë çështjeve gjyqësore të veçanta, në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, që janë konkretisht: {...} ... {...}.

Jeni dakord?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Vijojmë atëherë procedurat e shortit.

Valbona Bako: Gjyqtarja {...}.

Ilir Toska: Atëherë, mbyllem procedurat e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec.

Vijojmë me procedurat e shortit për gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Vlorë, fillimisht me **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat**, që ka paraqitur nevojë në 1 çështje, që është në lëndë penale dhe kërkohet caktimi i dy gjyqtarëve. Propozimi i Komisionit konsiston si më poshtë, gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 çështjeve gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeve gjyqësore të veçantë, të jetë 2, që duhet të përzgjidhen nga Seksioni Penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

Në këtë rast, ky propozim vijon me propozimin për përjashtim nga shorti, që është vetëm sa i përket kryetares në detyrë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, znj. {...}.

Jeni dakord?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Vijojmë me procedurën e shortit.

Valbona Bako: {...} dhe {...}.

Ilir Toska: Me kaq mbyllet procedura e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat.

Vazhdojmë me procedurat e shortit për **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë**. Ka paraqitur nevojë në 1 çështje, që është në lëndë penale dhe kërkohet caktimi i 1 gjyqtari.

Propozimi i Komisionit është që gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1.

Në këtë rast, propozimi vijues është për sa i përket përjashtimit nga shorti, të kryetarit në detyrë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, z. {...}.

Jeni dakord me propozimin?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Mirë atëherë, vijojmë me procedurat e shortit.

Valbona Bako: {...}.

Ilir Toska: Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Vazhdojmë me procedurat e shortit për gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Shkodër, që është vetëm Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë. Ka paraqitur nevojë në 1 çështje penale. Kërkohej caktimi i 3 gjyqtarëve.

Propozimi i Komisionit është që gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jenë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 3.

Në këtë rast, sa i përket përjashtimeve nga shorti, kemi propozuar të përjashtohen nga shorti kryetarët në detyrë të këtyre dy gjykatave, zoti {...} dhe zoti {...}.

Jeni dakord?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Dakord. Mirë atëherë, vazhdojmë me procedurat e shortit.

Valbona Bako: {...}, {...} dhe {...}.

{...}, relator i çështjes.

Ilir Toska: Mirë atëherë, mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë.

Vazhdojmë me gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit administrativ. Fillimisht, **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë.**

Ka paraqitur nevojë në 2 çështje. Kërkohet caktimi 1 gjyqtari në secilën nga ato.

Propozimi i Komisionit është që gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta të jetë Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 1.

Në këtë rast, si propozim vijues është që të mos përjashtohet nga shorti kryetari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, zoti {...}, për shkak të ngarkesës së ulët të kësaj gjykate dhe numrit të kufizuar të saj.

Jeni dakord?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Vazhdojmë atëherë me procedurat e shortit.

Valbona Bako: {...}.

Ilir Toska: Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë.

Vazhdojmë me procedurat e shortit për **Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë**. Ka paraqitur nevojë në 1 çështje. Kërkohet caktimi i 1 gjyqtari.

Propozimi i Komisionit është që gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1.

Në këtë rast, propozimi vijues është që të mos përjashtohet nga shorti kryetari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, z. {...}, për shkak të ngarkesës relativisht të ulët të kësaj gjykate dhe numrit të kufizuar të gjyqtarëve të saj.

Jeni dakord?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Vazhdojmë me procedurat e shortit.

Valbona Bako: {...}.

Me kaq mbyllen procedurat e shortit edhe për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Vazhdojmë me procedurat e shortit për gjykatat e apelit. Fillimisht kemi **Gjykatën e Apelit Korçë**. Sa i përket Gjykatës së Apelit Korçë, po ju lexoj paraprakisht propozimet e Komisionit. Nëse pranohen, do duhet të bëjmë vetëm një short manual për një moment dhe pastaj të vazhdojmë me procedurat për caktimin e gjyqtarëve përmes shortit elektronik.

Atëherë, Gjykata e Apelit Korçë ka paraqitur nevojë për 20 çështje (10 nga të cilat në lëndë penale, kërkohet caktimi i 1 dhe 2 dhe 3 gjyqtarëve si dhe në 10 çështje civile, ku kërkohet caktimi i 1 dhe 2 gjyqtarëve).

Propozimi i Komisionit është: Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 20 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jenë Gjykata e Apelit Tirane, Gjykata e Apelit Shkodër dhe Gjykata e Apelit Durrës. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 20 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 7 gjyqtarë, 3 gjyqtarë nga Gjykata e Apelit Tiranë, 3 gjyqtarë nga Gjykata e Apelit Shkodër dhe 1 gjyqtar nga Gjykata e Apelit Durrës.

Në opsionin e pranimin të këtij propozimi, sa i përket hapave të shortit, propozimet vijuese janë, sa i përket çështjeve penale: Për 10 çështjet penale, ndërsa për to kërkohet caktimi i 3 gjyqtarëve në 2 çështje, i 2 gjyqtarëve në 5 çështje dhe i 1 gjyqtari në 3 çështje, duke i ndarë ato në dy grup çështjesh, grupi i parë që përfshin çështjet nr.1, nr.3, nr.4, nr.6 dhe nr.9, si dhe grupi i dytë që përfshin çështjet nr.2, nr.5, nr.7, nr.8 dhe nr.10, të caktohen 6 gjyqtarë, të cilët të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Seksionit Penal të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Shkodër, nga 3 gjyqtarë prej secilës nga këto gjykata. Fillimisht përzgjidhen me short 3 gjyqtarë nga Seksionit Penal të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe Gjykatës së Apelit Shkodër. Më pas zhvillohet shorti për ndarjen e 2 grup çështjeve si më lart me gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe të Gjykatës së Apelit Shkodër.

Në vijim zhvillohet shorti për shpërndarjen e çështjeve tek gjyqtarët e përzgjedhur dhe konkretisht: për grupin e parë të çështjeve: Për çështjen nr.1, për të cilën kërkohet caktimi i 3 gjyqtarëve, të përzgjedhur nga shorti janë ata sipas atyre që do të përzgjidhen nga shorti që do të bëhet mes gjyqtarëve të Seksionit Penal të Gjykatës së Apelit Tiranë

dhe mes atyre të Gjykatës së Apelit Shkodër. Në këtë rast, gjyqtari i përzgjedhur i pari caktohet edhe si relator i çështjes.

Për çështjet nr.4, nr.6 dhe nr.9, për të cilat kërkohet caktimi i 2 gjyqtarëve, për secilën nga ato, gjyqtarët të përzgjidhen me short midis atyre të caktuar për çështjen nr.1.

Për çështjen nr.3, për të cilën kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, ai të përzgjidhet me short midis 2 gjyqtarëve të caktuar si anëtar për çështjen nr.1.

Për grupin e dytë të çështjeve, janë këto propozime: për çështjen nr.2, për të cilën kërkohet caktimi i 3 gjyqtarëve, të përzgjedhur nga shorti janë ata sipas pikës 2. Në këtë rast, gjyqtari i përzgjedhur i pari caktohet edhe si relator i çështjes.

Për çështjet nr.5 dhe nr.7, për të cilat kërkohet caktimi i 2 gjyqtarëve, për secilën nga ato, gjyqtarët të përzgjidhen me short midis atyre të caktuar për çështjen nr.2.

Për çështjet nr.8 dhe nr.10, për të cilat kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, për secilën nga ato, ai të përzgjidhet me short midis 2 gjyqtarëve të caktuar si anëtarë për çështjen nr.2.

Për çështjet civile: Për 10 çështjet civile, ndërsa për to kërkohet caktimi i 2 gjyqtarëve në 3 çështje dhe i 1 gjyqtari në 7 çështje, nga të cilat në 2 prej tyre trupi gjykues është i formuar nga 2 gjyqtarë të Gjykatës së Apelit Durrës dhe të Gjykatës së Apelit Shkodër, të caktohen 4 gjyqtarë, ku 2 nga të cilët të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Seksionit Civil të Gjykatës së Apelit Tiranë, kurse 2 gjyqtarët e tjerë nga ata të Gjykatës së Apelit Durrës dhe të Gjykatës së Apelit Shkodër, nga 1 prej secilës nga ato dhe më konkretisht: Për çështjet nr.15, nr.18 dhe nr.20, për të cilat kërkohet caktimi i 2 gjyqtarëve, ata të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Seksionit Civil të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Për çështjet nr.12, nr.14, nr.16, nr.17 dhe nr.19, për të cilat kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, për secilën nga ato, ai të përzgjidhet me short nga 2 gjyqtarët e Seksionit Civil të Gjykatës së Apelit Tiranë të caktuar për çështjet sipas shkronjës “a”, pra për çështjet 15, 18 dhe 20.

Për çështjen nr.11, për të cilën kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, ai të përzgjidhet me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Durrës.

Për çështjen nr.13, për të cilën kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, ai të përzgjidhet me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Shkodër.

Propozimet vijuese janë sa i përket përjashtimeve nga shorti.

Është përjashtuar të përjashtohet nga shorti kryetarët në detyrë të Gjykatës së Apelit Tiranë, Durrës dhe Shkodër, konkretisht: {...} ... {...}.

Po kështu të përjashtohen nga shorti edhe gjyqtarët e Seksionit Civil të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë që janë me leje afatgjatë nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë, {...} dhe z. {...}.

Po kështu të përjashtohen nga shorti e gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë që janë caktuar më parë për gjykimin e 12 apo më shumë çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme, që janë {...} ... {...}.

Po kështu në shortimin e çështjes sa i përket gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Shkodër, të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e kësaj gjykate që nuk janë në detyrë për paaftësi të përkohshme, prej gati 2 muajsh, sipas njoftimit të bërë nga kryetari i kësaj gjykate, që janë zonja {...} dhe zonja {...}.

Për çështjet penale përjashtohen nga shorti gjyqtari i Seksionit Penal të Gjykatës së Apelit Tiranë, që ka depozituar kërkesë për dorëheqje nga statusi i magjistratit, zoti {...}.

Në shortimin e çështjes civile nr. 11, përjashtohen nga shorti gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Durrës që janë caktuar më herët për gjykimin e kësaj çështjeje, që janë zoti {...} dhe {...}.

Dhe në shortimin e çështjes civile nr. 13 të përjashtohet nga shorti gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Shkodër që janë caktuar më herët për gjykimin e kësaj çështjeje, konkretisht zoti {...} dhe znj. {...}.

Këto janë propozimet që i kemi bërë me shkrim.

Atëherë, një propozim që po e bëj në këtë moment është sa i përket gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Durrës, zoti {...}, i cili dje ka pas seancë dëgjimore në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit dhe është shtyrë seanca për shpallje vendimi në datën 18. Nëse mendoni që mund ta përjashtojmë edhe zotin {...}.

Jeni dakord?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Dakord. Atëherë, reflektoje edhe propozimin e fundit në sistem sa i përket përjashtimit të gjyqtarit {...}.

Procedurat manuale të shortit për ndarjen në dy grup çështjesh penale mes gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe Gjykatës së Apelit Shkodër. Fut në një enë dy grupet e çështjeve, në një enë tjetër Gjykatën e Apelit Tiranë dhe Gjykatën e Apelit Shkodër dhe përzgjidhi.

Do përzgjedhim tre gjyqtarë të Gjykatës së Apelit Tiranë (do e bëjmë me procedurë manuale përzgjedhjen e tre gjyqtarëve). Kishte propozime shumë të ndërthurura dhe ishte e pamundur që sistemi ta bënte këtë gjë. Do ta bëjmë në ditët në vijim...

Valbona Bako: {...} ... {...}.

(Përzgjidhet manualisht nga një punonjës i administratës.)

Vildan Kaloshi: {...}, {...}, {...}.

Ilir Toska: U përzgjedhën tre gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë.

Do vazhdojmë të përzgjedhim tre gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Shkodër.

Valbona Bako: {...}, {...}, {...}.

Ilir Toska: Zonja {...} është pezulluar nga detyra ditën e djeshme, kështu që nuk merr pjesë në short.

Valbona Bako: {...} dhe {...}.

Ilir Toska: Të lutem zoti Kaloshi, zgjidh tre emra!

(Përzgjidhet manualisht nga një punonjës i administratës.)

Vildan Kaloshi: {...}, {...}, {...}.

Ilir Toska: Atëherë, u përzgjedhën edhe tre gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Shkodër. Do duhet të bëjmë një short manual për dy grupet e çështjeve penale, mes gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe Gjykatës së Apelit Shkodër.

Atëherë, duhet të hedhësh në një enë dy grupet e çështjeve, në enën tjetër Gjykata e Apelit Tiranë dhe Gjykata e Apelit Shkodër.

Valbona Bako: Grupi i parë çështjet numër 1, 3, 4, 6 dhe 9.

Grupi i dytë i çështjeve numër 2, 5, 7, 8 dhe 10.

Ilir Toska: Kush është grupi i parë?

Valbona Bako: Grupi i parë i çështjeve është 2, 5, 7, 8 dhe 10

Ilir Toska: Po! Është grupi i dytë i çështjeve.

Përzgjidh atëherë gjyqtarët.

Valbona Bako: Janë gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Shkodër: {...}, {...} dhe {...}.

Ilir Toska: Okej! Këto reflektoi tani tek sistemi që ta bëjmë procedurën e shortit në mënyrë elektronike.

Valbona Bako: Në grupin e dytë të çështjeve, gjyqtarët që do marrin pjesë në lotari janë {...}, {...} dhe {...}.

Atëherë, tre gjyqtarët e përzgjedhur për çështje që kanë kërkuar tre gjyqtarë, janë {...}, {...}, {...}.

Për çështjet që kanë kërkuar 2 gjyqtarë, kemi {...} dhe {...}.

Ndërsa për çështjet në të cilat kërkohet 1 gjyqtar, kemi {...}.

Ilir Toska: Tek çështja që është me tre gjyqtarë, relator është?

Valbona Bako: {...}.

Ilir Toska: Vazhdojmë me grupin e parë të çështjeve.

Valbona Bako: Atëherë, për çështjet që kërkojnë tre gjyqtarë, janë përzgjedhur {...}, {...} dhe {...}. {...}, relator.

Për çështjet që kërkojnë 2 gjyqtarë, të përzgjedhur janë {...} dhe {...} (për çështjen nr. 120), dhe për çështjen me nr. 37, gjyqtarët e përzgjedhur janë {...} dhe {...}, për çështjen penale nr. 16, i përzgjedhur është gjyqtari {...}. Çështja me nr. 128 është {...} dhe {...}. Domethënë 128-ta është me nr. 9 në tabelë.

Janë 10 çështje civile, që i kemi nga Seksioni Civil i Gjykatës së Apelit Tiranë. Gjyqtarët e përzgjedhur për çështjet që kërkojnë 2 gjyqtarë janë: {...} dhe {...}. Për çështjen nr. 352, gjyqtarja e përzgjedhur {...}. Për çështjen 409, {...}. Për çështjen 350, gjyqtari {...}. Për çështjen 316, gjyqtarja {...} dhe për çështjen 62, {...} dhe {...}.

Atëherë, çështja civile nr. 11, nga gjyqtarët e apelit Durrës do heqim {...} - Gjyqtar {...}.

Gjyqtari {...} (përzgjidhet për çështjen nr. 13).

Ilir Toska: Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Apelit Korçë.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Apelit Vlorë**. Gjykata e Apelit Vlorë ka paraqitur nevojë në 5 çështje, 2 në lëndë civile dhe 3 në lëndë penale. Kërkohet caktimi i 1 dhe 2 dhe 3 gjyqtarëve.

Propozimet e Komisionit janë: Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 5 çështjeve, të jetë Gjykata e Apelit Durrës dhe Gjykata e Apelit Gjirokastrë. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 5 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 5, 2 gjyqtarë nga Gjykata e Apelit Durrës dhe 3 gjyqtarë nga Gjykata e Apelit Gjirokastrë.

Propozimet vijuese janë: Për çështjen civile nr.2, për të cilën kërkohet caktimi i 2 gjyqtarëve, ata të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Durrës.

Për çështjen civile nr.1, për të cilën kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, ai të përzgjidhet me short ndemjet dy gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Durrës të caktuar për çështjen nr.2.

Për çështjen penale nr.5, për të cilën kërkohet caktimi i 3 gjyqtarëve, ata të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, ku gjyqtari i përzgjedhur i pari është dhe relator i çështjes.

Për çështjen penale nr.4, për të cilën kërkohet caktimi i 2 gjyqtarëve, si të përzgjedhur nga shorti të konsiderohen dy gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë të caktuar për çështjen nr.5.

Ndërsa, për çështjet penale nr.3, për të cilën kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, ai të përzgjidhet me short midis gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë të caktuar për çështjen nr.5.

Propozimet vijuese janë për sa i përket përjashtimeve nga shorti. Është propozuar të përjashtohen nga shorti kryetarët në detyrë të Gjykatës së Apelit Durrës dhe Gjirokastrë, konkretisht zoti {...} dhe zoti {...}.

Po kështu është propozuar që të përjashtohen nga shorti edhe gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Durrës të cilët janë caktuar më parë për gjykimin e 12 apo më shumë çështjeve gjyqësore të veçanta, në gjykata të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme, konkretisht zoti {...} dhe zoti {...}.

Dhe së fundi, propozimi që po e bëj me gojë është sa i përket zotit {...} që është në seancë dëgjimore përpara Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Jeni dakord?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Mirë atëherë, vazhdojmë me procedurat e shortit.

Valbona Bako: Për çështjen nr.1 gjyqtari i përzgjedhur është {...}.

Për çështjen nr.2 janë gjyqtarët {...} dhe {...}.

Për çështjen 5, gjyqtarët e përzgjedhur janë {...} (relatore), {...} dhe {...} (anëtarë).

Për çështjen nr. 4 janë gjyqtarët {...} dhe {...}.

Ilir Toska: Për çështjen nr. 3?

Valbona Bako: {...}.

Ilir Toska: Mbarojnë procedurat e shortit për Gjykatën e Apelit Vlorë.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Apelit Gjirokastrë**. Gjykata e Apelit Gjirokastrë ka paraqitur nevojë në 3 çështje, 1 në lëndë penale dhe 2 në lëndë civile. Kërkohen 3 dhe 1 gjyqtar.

Propozimi i Komisioni është: Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtarët që do të caktohet për gjykimin e 3 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jenë Gjykata e Apelit Vlorë dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 3 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 3.

Propozimet vijuese janë: Për çështjen penale nr.1 dhe për çështjen civile nr.3, për të cilat kërkohet caktimi i 3gjyqtarëve, ata të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Vlorë. Në këtë rast, gjyqtari i përzgjedhur i pari caktohet automatikisht si relator i çështjes nr.1, ndërsa ai i përzgjedhur i dyti, si relator për çështjen nr.3.

Për çështjen civile nr.2, për të cilën kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, ai të përzgjidhet me short midis 2 gjyqtarëve të caktuar anëtar për çështjen penale nr.1.

Kemi paraqitur propozime vijuese sa i përket përjashtimeve nga shorti: që të përjashtohen nga shorti kryetarja në detyrë e Gjykatës së Apelit Vlorë, zonja {...}. Po

kështu, të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Vlorë që kanë pengesë ligjore për gjykimin e çështjes penale, që janë zoti {...}, {...} dhe {...}.

Jeni dakord?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Vazhdojmë me procedurat e shortit.

Valbona Bako: Për çështjen e parë, gjyqtarët janë {...}, {...} dhe {...}. {...} relatore.

Për çështjen e dytë {...}, {...} dhe {...}. {...} relator.

Dhe për çështjen e tretë është gjyqtarja {...}.

Ilir Toska: Me kaq mbyllen procedurat e shortit.

Brikena Ukperaj: Atëherë, një propozim lidhur me gjyqtaren {...}. Ajo është aktualisht gjyqtare e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Ushtron funksionet deri në fund të vitit 2019. Është përjashtuar me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor nga procedurat e ndarjes së çështjeve me short në gjykatën ku është dhe herë të tjera i kemi përjashtuar anëtarët e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nga procedurat e delegimeve apo të caktimeve në çështje të tjera nga gjykata të tjera nga ato ku ushtrojnë funksionin. Kështu që do të propozoja që shorti të përsëritet, duke përjashtuar gjyqtaren {...}.

Ilir Toska: Meqenëse Këshilli është dakord, e anulohet kështu procedurë shorti, të konsiderohet në propozim edhe përjashtimin e gjyqtares {...} dhe ribëje edhe një herë shortin.

(Aktualisht sistemi elektronik nuk e ka të parashikuar për të anuluar shortin dhe për të bërë një short të ri, caktimi i gjyqtarëve në këtë rast bëhet manualisht.)

Mirë, meqenëse sistemi elektronik nuk kthehet mbrapsht, nuk është parashikuar opsioni për anulimin, do duhet ta zhvillojmë manualisht shortin për sa i përket Gjykatës së Apelit Gjirokastrë. Atëherë, referuar faktit që janë pranuar propozimet për përjashtim nga shorti të disa gjyqtarëve, gjyqtarët që mbeten, praktikisht janë vetëm tre gjyqtarë: gjyqtarët {...}, {...} dhe {...}.

Do duhet atëherë të zhvillojmë procedurat e shortit për relatorin për çështjen nr. 1 dhe nr. 3 dhe për çështjen nr. 2, që praktikisht janë dy gjyqtarë që do të zgjidhen anëtarë për çështjen penale nr. 1.

Hidhi në një enë atëherë emrat e tre gjyqtarëve, për të përzgjedhur relatorin për çështjen nr. 1.

Valbona Bako: {...}.

Ilir Toska: Atëherë, për çështjen penale nr. 1, në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë janë gjyqtarët {...}, {...} dhe {...}, ku relatores është?

Valbona Bako: {...}.

Ilir Toska: {...}.

Do zgjedhësh një emër tjetër që është relator për çështjen nr. 3.

Valbona Bako: {...}.

Ilir Toska: Që është {...}.

Dhe ndërkohë për çështjen civile nr. 2, për të cilën kërkohet caktimi i një gjyqtari, ai të përzgjidhet me short midis 2 gjyqtarëve të caktuar anëtar për çështjen penale nr.1, pra mes gjyqtarëve {...} dhe gjyqtarit {...}. Do zgjedhim njërin prej tyre që do të caktohet për çështjen civile nr. 2.

Valbona Bako: {...}.

Ilir Toska: Atëherë edhe për çështjen civile nr. 2 përzgjidhet me short gjyqtari {...}. Me kaq mbyllet procedurat e shortit për Gjykatën e Apelit Gjirokastrë.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Apelit Shkodër**. Gjykata e Apelit Shkodër ka paraqitur nevojë 2 çështje që janë në lëndë penale. Kërkohet caktimi i 1 dhe 2 gjyqtarëve.

Atëherë, propozimet e Komisionit janë që të pranohet pjesërisht kërkesa në lidhje me çështjen nr.2, duke u caktuar për këtë çështje vetëm 1 gjyqtar në kushtet e mosevidentimit të nevojës për 2 gjyqtarë në kuptim të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 30, datë 14.02.2019, “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Apelit Durrës.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 2 çështje gjyqësore të veçanta, të jetë 1.

Propozimet vijuese janë sa i përket përjashtimeve nga shorti. Të përjashtohet kryetari në detyrë e Gjykatës së Apelit Durrës, z. {...}. Po kështu të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Durrës që janë caktuar më parë për gjykimin e 12 apo më shumë çështjeve gjyqësore të veçanta që janë zoti {...} dhe {...}.

Në shortimin e këtyre çështjeve të përjashtohen nga shorti edhe gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Durrës që do caktohen për gjykimin e çështjes gjyqësore.. që u caktuan në Gjykatën e Apelit Vlorë.

Propozimi i fundit është sa i përket zotit {...} që është në proces në seancë dëgjimore përpara Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Jeni dakord?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Dakord.

Valbona Bako: Duhet të heqim edhe {...} dhe {...}.

Nëse heqim edhe gjyqtarin {...} i bie të mbetet vetëm gjyqtari {...}.

Ilir Toska: Mbaroi shorti për Gjykatën e Apelit Shkodër. Caktohet gjyqtari {...}.

Vazhdojmë procedurat e shortit për **Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda**. Ka paraqitur nevojë për 1 çështje. Kërkohen 2 gjyqtarë.

Propozimet e Komisionit janë: Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Apelit Tiranë dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 2 gjyqtarë. Në këtë rast vijojmë me përjashtimet nga shorti të kryetarit të detyrë të Gjykatës së Apelit Tiranë zoti {...}; të dy gjyqtarëve që nuk janë në detyrë, me leje afatgjatë nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë {...} dhe {...}; me përjashtimin e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Tiranë që ka depozituar kërkesë për dorëheqje nga statusi i magjistratit, zoti {...}; me përjashtimin nga shorti të gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Tiranë që janë caktuar më parë për gjykimin e 12 apo më shumë çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme, që janë: zoti {...}, {...}, zonja {...} dhe zonja {...}; po kështu të përjashtohen nga shortimi i çështjeve edhe gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë që u caktuan për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në Gjykatën e Apelit Korçë.

Të përjashtohet, verbalisht tani po e bëj propozimin tjetër, që është sa i përket gjyqtarit {...}, që është anëtar i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Jeni dakord?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Dakord. Mund të vazhdosh procedurat e shortit.

Valbona Bako: Valdete Hoxha dhe Genti Shala.

Ilir Toska: Me kaq mbyllen edhe procedurat e shortit edhe për Gjykatën e Apelit për krimet e Rënda dhe vijojmë me gjykatën e fundit që është **Gjykata e Lartë**.

Ka paraqitur nevojë për 4 çështje që janë për ekstradime. Kërkohet caktimi i 2 gjyqtarëve.

Propozimet e Komisionit janë që gjykata nga duhet të përzgjidhen gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 4 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jenë gjykatat e apelit me juridiksion të përgjithshëm dhe Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda. Gjyqtarët për 4 çështjet gjyqësore të veçanta, të përzgjidhen, me short, ndërmjet atyre të cilët kanë të paktën 13 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit, si dhe kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 4 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 2.

Atëherë, gjyqtarët që plotësojnë kriteret si më lart janë 8, konkretisht: {...} ... {...}.

Jeni dakord?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Dakord atëherë. Vazhdojmë me procedurat e shortit.

Valbona Bako: {...} dhe {...}.

Ilir Toska: Mbaroi edhe shorti për Gjykatën e Lartë dhe të gjithë procedurat e shortit. Faleminderit!

Maksim Qoku: Atëherë, me pikën e fundit të çështjeve të rendit të ditës, ju falënderoj për pjesëmarrjen, nëse nuk ka gjë tjetër, e mbyllim mbledhjen e kësaj dite.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor